



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr.8, datë 04.09.2025

PËR

**KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR.10
DATË 8.5.2023 DHE LEJES ME NR SERIE 000115 “PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK” HEC “KEBELA”
SUBJEKTIT “OSMANI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 141, të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore”, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 dhe 2 të nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”. 1-Organ i publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2-Organ i publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njëhësuar të tij. AMBU dhe Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor Shkumbin-Seman pasi konstatoi se pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujqor Seman,

V E N D O S I:

1. Korigjimin e gabimit në Vendimin nr.10 datë 8.5.2023 dhe Lejes me nr serie:000115 “Përpërdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet HEC “Kebela”, me vendndodhje në lumin Devoll, degë e lumit Seman, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan të subjektit “Osmani” sh.p.k.



2. Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)

Nga: X=524517; Y=4516195; Z=293 m.m.n.d.

Në: X=524720; Y= 4516210; Z= 293 m.m.n.d

3. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBUSEMAN

ARBEN ÇUKO

